



VENDIM

Nr. 107, Datë 18.08.2015

**PËR
FILLIMIN E PROÇEDURAVE PËR LIÇENCIMIN E SHOQËRISË
ENERGY SUPPLY SH.P.K NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 20 gërma “b”; 37 pika 2, gëma “ç”, dhe 110 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4 pika 1 gërma “f”; 5 pika 1 gërma “f” 8; 10, pika 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/ të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008, nenit 18, pika 1 gërma “a”, të “Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve, Nr. 21, datë 18.03.2009, Bordi i E.R.E, në mbledhjen e tij të datës 18.08.2015, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “ENERGY SUPPLY” sh.p.k për liçensimin në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike dhe relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “**ENERGY SUPPLY**” sh.p.k, plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/ të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave” si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Te dhënat specifike sipas tipit të liçensës (neni 9 pika 4/9 gërma “b” është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me: Sasinë e energjisë mesatare të parashikuar për furnizimin e konsumatorëve dhe kapitalin financiar të shoqërisë, (neni 9, pika 4/9, gërmat“a” dhe “c”), do të njoftohet subjekti që në bazë të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit , Transferimit te Plote / te Pjessbëm dhe Rinovimit te Licensave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, ti paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi :

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Energy Supply” sh.p.kpër licencimin në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe të të Licensuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit AHMETI